



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

KRYETARI

Nr. 2305 Prot

Roskovec, më 25.03.2021

VENDIM

Nr. 30 datë 25.03.2021

**“PËR
AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE EDUKATIVE
GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE,
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021 ”**

Në mbështetje dhe ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” ; neni 8, pika 2 ; të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar” neni 79 ; të ligjit 90/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580 datë 17.02.2020 “Për partitë politike”; të ligjit nr. 8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës” azhornuar me ligjin nr.8335 datë 23.04.1998; si dhe të Udhëzimit nr.6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

Vendosa:

- 1.Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor , jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
- 3.Të gjithë subjektet zgjedhore duhet të njoftojnë me shkrim për adresat e sakta të zyrave elektorale. Brenda 5 (pesë) ditëve kryhet verifikimi i vendndodhjes së tyre në respektim të dispozitave të Udhëzimit nr.6 datë 23.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për afishimin dhe vendosjen e materialeve propagandistike.

4.Nëse materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore vendosen në kundërshtim me këtë Vendim, Policia Bashkiake merr masa të menjëhershme për heqjen e tyre.

5.Pranë ambjenteve të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum lejohet afishimi i **materiale edukative zgjedhore**, në dispozicion të KQZ-së ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor por që i shërbejnë edukimit të zgjedhësve lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe të votimit sipas Kodit Zgjedhor.

6.Një kopje e këtij Vendmi i dërgohet Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve menjëherë pas zbardhjes.

7.Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec.

KRYETAR
Majlinda Bufi

